



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 971/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevc, kryesues, Kymete Kicaj dhe Ferki Xhaferi, anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelin e Valon Svirçës, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Obiliq, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.971/2021 i datës 04.11.2021, i parashtruar Valon Svirca, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Obiliq, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021, nga Valon Svirca, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Obiliq, me të cilin pretendon se në Vendvotimin 1510E/02D, në Mazgit të Epërm sipas tij e kanë votuar së paku 5 familjarët e tij.

Parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur asnjë provë si dëshmi për shkeljet e pretenduara.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga Valon Svirca, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Obiliq, është i pabazuar pasi që Paneli vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apeluës nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkrete por janë vetëm pretendime të supozuara dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidaten në fjalë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.971/2021 më datën 06.11.2021

Kryesues i Panelit
Adnan Konushevc



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.